



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 53 prot., i AK, datë 19.01.2022, “Njoftim përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar mbi përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l.

Referuar “Marrëveshje shitje dhe transferimi aksionesh në lidhje me Mooney Group S.p.A.”, dhe “Marrëveshjes Kuadër”, të nënshkruara më datë 23 dhjetor 2021, palët në marrëveshje janë:

**Pala Blerëse:**

**Blerësi 1:** Banka 5 S.p.A. është një shoqëri aksionare e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve bankare, si dhe shërbime grumbullimi dhe pagese për shitësit monopol, si p.sh. tregtarët e duhanit etj. Banka 5 S.p.A. zotëron 30% të kapitalit të shoqërisë Mooney Group S.p.A.

Banka 5 S.p.A. është një bankë italiane, që i përket grupit të shoqërive të drejtuara nga Intesa Sanpaolo S.p.A. Intesa Sanpaolo S.p.A. është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo Group, një prej grupeve bankare kryesore italiane. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar me objekt aktiviteti: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime në përputhje me ligjin nr.52/2014.

**Blerësi 2:** Enel X S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti fokusimin në zhvillimin e produkteve inovative dhe zgjidhjeve dixhitale në fushat ku energjia tregon potencialin më të madh të transformimit, p.sh., qytetet inteligjente dhe lëvizshmëria elektronike. I gjithë kapitali aksionar i shoqërisë Enel X S.r.l. zotërohet nga shoqëria Enel S.p.A. Enel S.p.A. është shoqëria mëmë e Grupit Enel, i cili është aktiv në mbarë botën në sektorin e energjisë dhe gazit natyror.

Grupi Enel nuk ka filiale, aktivitete dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

**Pala Shitëse:** Schumann Investments S.A është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Shoqëria SG2 S.p.A. zotëron 70% të kapitalit aksionar të shoqërisë target Mooney Group S.p.A.

**Target:** Mooney Group S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar në bazë të ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve nëpërmjet një rrjeti pikash shitjeje të ndërlidhura në Itali (p.sh., shitës duhani, bare dhe standat e gazetave) dhe nëpërmjet platformave dixhitale. Mooney Group S.p.A. gjithashtu ofron shërbime të biletave dixhitale të transportit në Itali përmes platformës MyCicero.

Mooney Group S.p.A. nuk ka filiale, aktivitete dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**